



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria*  
*Vlada-Government*  
*Ministria e Zhvillimit Ekonomik*  
*Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development*

**Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik shpallë **KONKURS PËR AVANCIM** të nëpunësve civilë për këtë vend të punës:

**Departamenti i Minerave - Divizioni i Politikave Minerare**

**Numri i Konkursit: APF0002173**

**Vendi i punës: Udhëheqës i Divizionit të Politikave Minerare EZHE/060 / JP00029313**

**Koeficienti : 9.00**

**Kohëzgjatja e Emërimit: me afat te caktuar 06/05/2020**

**Mbikëqyrësi: Drejtori i Departamentit te Minerave**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Udhëheq procesin e hartimit dhe rishikimit të dokumenteve të politikave/strategjive në sektorin minerar;
- Propozon, harton dhe monitoron zbatimin e legjislacionit për sektorin minerar;
- Harton raporte të rregullta periodike mbi zbatimin e Strategjisë Minerare dhe legjislacionit për sektorin minerar;
- Harton dhe monitoron planet për zhvillim te komuniteteve të ndikuara nga aktivitetet minerare;
- Ofron mbështetje në shqyrtimin dhe propozim-miratimin e Planit të Menaxhimit të resurseve minerale;
- Shqyrton planet hapësinore lidhur me menaxhimin e resurseve minerale.

**Kualifikimi i nevojshëm :**

- Diplomë Universiteti nga lemia e shkencave teknike.
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune.

- Aftësi menaxheriale dhe punë ekipore;
- Aftësi në ndërmarrjen e iniciativave;
- Njohuri e legjislacionit përkatës vendor dhe ndërkombëtar për lëmin e xehetarisë, përpunimit, shfrytëzimit dhe plasmanit të produkteve minerale;
- Aftësi të avancuara me kompjuter MS Windows, MS Office (Word, Exel, Power Point, Project, Outlook);
- Aftësi komunikimi (shkrim dhe prezantim oral) në gjuhën Shqipe ose serbe, njohja e gjuhës angleze është përparësi,
- Aftësi të punon në mënyrë efektive në mjedisin multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Aftësi të punon në nivelin më të lartë të konfidencialitetit dhe transparencës;

**INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT PER AVANCIM**

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunës civil ekzistues në MZHE, te cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. MZHE ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MZHE-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës, dy vlerësimet e fundit të punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

**Afati i konkurrimit është prej datës 13/06/2017 deri me date 20/06/2017, deri në orën 16:00.**

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524.